



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A.

Durrës më, ___/___/2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

SHËRBIM I PRINTIMIT DHE FOTOKOPJIMIT

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

SHËRBIME TË FOTOKOPJIMIT 79521000-2

SHËRBIME PRINTIMI 79810000-5

VLERA E FONDIT LIMIT:

6,000,000 (GJASHTË MILION) LEKË PA TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sha** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kërkesave të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit 2.2

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2019, 2020 dhe 2021** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43, pika 2, gërma c) e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për MRRPP, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922

datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021, të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenin 9, të Ligjit Nr.25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetimet që dëshmojnë se operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vëndet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitetet për vitin 2021 sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr. 9632/2006 ”Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Kriteri sipas pikës 2.2.3 do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit ku operatorët ekonomike duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2021 sipas parashikimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi **për shërbimet** e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (*apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot*).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

- a) Të paktën 1 (nje) Inxhinier Elektronik
- b) Të paktën 1 (nje) Inxhinier Mekatronik
- c) Të paktën 1 (nje) Inxhinier IT/Informatike

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratat e punës
- Diplomat
- Listëpagesat e miratuara për periudhën Janar - Qershor 2022

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të

Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

- a) Të paktën 1 (nje) Inxhinier Elektronik për të instaluar dhe konfiguruar pajisje multifunkionale (printera fotokopje skaner) dhe pershtatja me rrjetin ekzistues të AK.
- b) Të paktën 1 (nje) Inxhinier Mekatronik për të instaluar dhe konfiguruar pajisje multifunkionale, evidentuar , interpretuar problematikat e mundshme gjate përdorimit të pajisjes dhe zgjidhja e problemit.
- c) Të paktën 1 (nje) Inxhinier IT/Informatike për të instaluar dhe konfiguruar pajisje multifunkionale me software perkates. Te lexoje dhe interpretoje software-in , pjese e prokurimit.

(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar shërbimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe nëse është rasti, për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 5 persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllëgaritur si më poshtë:

3 (tre) inxhinier sipas kërkesave në pikën 2.3.2 dhe 2(dy) shoferë që do të kryejnë transportin e pajisjeve artikujve të printerave.

(Shënim- Specifikoni proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës së shërbimit, si dhe numrin e punonjësve të nevojshëm në çdo rast, bazuar në analizën e kryer).

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë, që janë në përputhje me objektin e kontratës, certifikatat kerkohen të jene të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. si me poshte:

- ISO 9001-2015 (për Sistemin e Menaxhimit të Cilesisë) ose e përditësuar.
- ISO 27001-2013 (për Sigurinë e Informacionit) ose e përditësuar.
- ISO 20000-1:2011 (për Menaxhimin e Shërbimit Teknologjise Informacionit) ose e përditësuar.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nën të 36 dhe 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor* dhe neneve 40, pika 8, dhe 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

-Cerifikata per sistemin e menaxhimit te cilesise **ISO 9001:2015** eshte e nevojshme si kriter kualifikues pasi lidhet me natyren dhe vleren e kontrates, me qellim per te vertetuar dhe te garantoje realizimin ne kohe, me sukses dhe me cilesi sipas standarteve nderkombetare te objektit te kontrates.

- Përbushja e standartit **ISO 27001** është thelbësore, pasi siguron zbatimin e sigurisë së informacionit të shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka standartet e duhura për menaxhimin e sigurisë së informacionit gjatë zbatimit të kontratës.

- Përbushja e standartit **ISO 20000-1** është thelbësor pasi nëpërmjet këtij certifikimi, Operatori Ekonomik duhet të demonstrojë si ofrues shërbimi aftësinë për të planifikuar, implementuar, operuar, monitoruar rishikuar dhe përmirësuar shërbimet e ofruara. Ky lloj certifikimi garanton gjithashtu Autoritetin Kontraktor se shërbimet e ofruara gjatë zbatimit të kontratës janë sipas standarteve ndërkombëtare për menaxhimin e shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë certifikatën ISO sa më sipër specifikuar.

2.4.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose broshurë për mallin, letren dhe softwar-in që oferton. Katalogu ose broshura duhet të jenë të përkthera, noterizuara si dhe të markuara për verifikimin e specifikimeve teknike të pajisjeve si më poshtë:

- 10 Fotokopje/Printer/Skaner(me ngjyra) A3 me shpejtesi printimi ≤ 45
- 6 Fotokopje/Printer/Skaner A3 Bardh e zi me shpejtesi printimi ≤ 55
- 5 Fotokopje/Printer/Skaner(Bardh/Zi) A4 me shpejtesi printimi ≤ 55
- Software per leximin, menaxhimin, raportimin sipas userave apo departamenteve, ne lidhje me faqet e printuara, fotokopjuara,

Për Letër A4+A3 79.5-80.5 g/m² , operatori ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit/skedën teknike, në të cilën të gjejnë pasqyrim specifikimet teknike të kërkuara me

produktet e ofruara. Katalogu/ skeda teknike duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

OE duhet të deklarojë adresat, nr. tel, email, emer mbiemer te personave te kontaktit ne kompanine prodhuese apo distributore, për verifikimin e te dhenave.

Shenim : Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosija e kriterit të sipërcituar është vënë në mbështetje të nenit 40 pika 6 gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar parashikohet shprehimisht... Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogjet teknike

Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

2.4.3 Operatori ekonomik duhet të deklarojë që merr përsipër transportin e pajisjeve dhe implementimin pranë ambjenteve të Autoritetit Kontraktor Brenda afatit të parashikuar.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

- Në cmimin e dhënë përfshihet Letra A3/A4. Duhet të përfshihen pajisjet (21 pajisje A4 & A3 bardhe zi dhe color), te gjithë tonerat e nevojshëm deri në përfundim të kontratës së mjaftueshme për printime deri në përfundimin e kontratës, drumet dhe cdo pjesë këmbimi tjetër për mirëfunksionimin e pajisjeve.
- Te gjithë tonerat duhet të jenë origjinale të llojit të printerit ose ekuivalent me të dhe të qëndrojnë stok në magazinën e institucionit. Të paktën një toner rezervë për cdo tip pajisje funksionale, duhet të jetë prezent në magazinën e institucionit.
- Operatori ekonomik duhet të përgjigjet brenda 4 (kater) orëve për difektet e pajisjeve. Në rastin kur pajisja nuk riparohet brenda 4 (kater) orëve, pajisja duhet të zëvendësohet brenda 24 oreve.
- Kohezgjatja e Shërbimit do të jetë për 12 muaj.
- Pajisjet do të vendosen në ambjentet e UK Durres, UK Kavaje, UK Kruje, UK Shijak, UK Rrogozhine.
- Pajisjet duhet të funksionojnë 24 orë në ditë
- Pajisjet duhet të funksionojnë si printer, fotokopje dhe skaner për te gjithë perdoruesit e mundshem duke u lidhur me rrjetin ekzistues të UK Durres, UK Kavaje, UK Kruje, UK Shijak, UK Rrogozhine.

Në rast të mosplotësimin të njërës nga kushtet e vendosura mësipër, Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për të skualifikuar apo anuluar kontratën në cdo moment.

Ujesjelles Kanalizime Durres per te realizuar shërbimin e printimit, fotokopjimit, skanimit kerkon keto pajisje sipas specifikimeve te poshte permendura

Nr.	Përshkrimi	Nj/M	Sasia
1	Pajisje Multifunktionale A3 me ngjyra	cope	10
2	Pajisje Multifunktionale A3 Bardh/Zi	cope	6
3	Pajisje Multifunktionale A4 Bardh/Zi	cope	5
4	Software		1
	Shuma e pajisjeve	cope	21

**Numri i këtyre pajisjeve mund të shtohet për shkak të kërkesës së lartë të fluksit të punës ose defekteve të riparueshme të pajisjeve që Autoriteti Kontraktor zotëron.*

Specifikime teknike të pajisjeve të kërkuara:

*** 10 Fotokopje/Printer/Skaner(me ngjyra) A3**

“Funksioni”:	Fotokopje/printer/skaner me ngjyra
Shpejtësia “Kopje/Print per A4	≥45 ppm
Rezolucioni	Min 1200x1200
Vendosja e dokumentit “Document Feeder”:	ADF/RADF
Kopjim/printim në të dy faqet “Duplex copying/print.”:	Po
Formati i letrës “Media sizes”:	A6-A3
Memoria	≥ 2 GB
Cikli mujor I punes	40000 Flete
Kapaciteti mbajtes se leteres	≥1200 Flete
Kapaciteti ne dalje I letres	≥500 Flete
Formati i skanimit maksimal “Maximum scan size”:	A3
Porta e komunikimit “Interface”	High Speed USB 2.0 / Ethernet
Skanimi	Full Network kolor Skan (Skan to e-mail,skan to folder ,skan to FTP)

*** 6 Fotokopje/Printer/Skaner A3 Bardh e zi**

“Funksioni”:	Fotokopje/printer/skaner
Shpejtësia “Kopje/Print per A4 B&W”:	≥55 ppm
Rezolucioni	min 1200x 1200
Vendosja e dokumentit “Document Feeder”:	ADF/DADF

Kopjim/printim në të dy faqet “Duplex copying/print.”:	Po
Formati i letrës “Media sizes”:	A6-A3
Memoria	≥ 1 GB
Kapaciteti mbajtes se leteres	≥1100 Flete
Kapaciteti ne dalje I letres	≥500 Flete
Formati i skanimit maksimal “Maximum scan size”:	A3 Kolor
Porta e komunikimit “Interface”	High Speed USB 2.0 / Ethernet
Finisher	Po
Skanimi	Full Network kolor Skan (Skan to e-mail,skan to folder ,skan to FTP)

***5 Fotokopje/Printer/Skaner(Bardh/Zi) A4**

“Funksioni”:	Fotokopje/printer/skaner me ngjyra
Shpejtësia “Kopje/Print per A4	≥55 ppm
Rezolucioni	Min 1200x1200
Vendosja e dokumentit “Document Feeder”:	ADF/RADF
Kopjim/printim në të dy faqet “Duplex copying/print.”:	Po
Formati i letrës “Media sizes”:	A6-A4
Memoria	≥1 GB
Cikli mujor I punes	350000 Flete
Kapaciteti mbajtes se leteres	≥1000 Flete
Kapaciteti ne dalje I letres	≥500 Flete
Formati i skanimit maksimal “Maximum scan size”:	A4
Porta e komunikimit “Interface”	High Speed USB 2.0 / Ethernet

Skanimi	Full Network kolor Skan (Skan to e-mail,skan to folder ,skan to FTP)
---------	--

Specifikimet e Software	
1	Monitorimin i statusit te paisjeve ne kohe reale.
2	I afte per menaxhimin, kontrollin, gjurmimin, numerimin, auditimin, logimin si dhe raportimin per cdo printim, kopje apo skaner ne baze perdoruesi apo departamenti.
3	I pershtatshem me te gjitha sistemet e operimit si Windows apo aplikacioneve Android/IOS etj.
4	Printimi I sigurte, autentikim I sherbimit nepermjet printimit me pin.
5	Autentikim printimi nepermjet kartave te check-in ekzistues te Personelit te Portit.
6	Pull dhe secure printing te implementohet ne paisjet qe kerkohet.
7	Mundesimi per upgrade automatik me ane te software te versioneve te fundit te firmwareve te pajisjeve.
8	Te mundesoje watermarking printing qe lejon vendosjen e nje vule dixhitale apo nje teksti te cfaredoshem ne cdo faqe printimi apo skanimi.

**Për këto operatori duhet të paraqesë katalog ose broshurrë*

Operatori ekonomik duhet të jetë Distributor Zyrtar për territorin e Republikës së Shqipërisë per software qe posedon/ ose te jete i i paisur me autorizimin nga distributori zyrtar vendas/rajonal ose ekuivalent për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi.

Në këtë rast operatori ekonomik duhet të deklarojë adresat, nr. tel, email, emer mbiemer te personave te kontaktit ne kompanine prodhuese për verifikimin e certifikateve.

Specifikimet teknike të letrës A4, A3 (Brand i njohur Nderkombetar).

1.	Letër fotokopje A4, 79.5-80.5 gr/m2 ngjyra e bardhe	Risma 500 flete
2.	Letër fotokopje A3, 79.5-80.5 gr/m2 ngjyra e bardhe	Risma 500 flete

Specifikime Letër A4/A3 79.5-80.5 g/m2 e bardhe:

- Cilësi e parë me certifikatë ISO,
- CIE Bardhësi: 158-170% dhe pa lluster,
- Peshë e një fije 79.5-80.5 gr/m2, dhe një rizme 500 fije x A4
- Përmasat të jenë 210x297cm A4
- Multifunkionale - për fotokopje, printer, faks,
- Lageshtira: 3 - 5 %,
- Trashësia 103-115 mm
- Drita: ≥ 95%
- Shkelqimi: 101-115%

Ambalazhimi: Mbështjellje kundër lagështirës dhe kuti me kapacitet 5 risma, letra të mos bllokojë makinën fotokopjuese apo printerin, fax-in, të qëndrojnë e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit, të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit, të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët, të plotësojë standardet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkiv, sipas ISO 9706, të mos jetë e ricikluar.

Shërbimi i printimit e fotokopjimit do të përfshijë: implementimin e pajisjeve nga operatori ekonomik, mirëmbajtjen e këtyre pajisjeve, furnizimin me mallra, (toner, pjesë këmbimi, konsumi dhe letër).

VOLUMI I PARASHIKUAR PËR PRINTIM DHE FOTOKOPJIM

Sasia e parashikuar për 12 muaj

NR.	PËRSHKRIMI	SASIA E PRINTIMEVE	Çmimi/Njesi
1.	Shërbim printimi A4 bardh/zi	2 500 000	
2.	Shërbim printimi A3 bardh/zi	150 000	
3.	Shërbim printimi A4 me ngjyra	50 000	
4.	Shërbim printimi A3 me ngjyra	50 000	

Afatet e levrimëve të pajisjeve: 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga lidhja e kontratës së shërbimit ose nga njoftimi zyrtar që do të japë Autoriteti Kontraktor për fillimin e shërbimit.